

RREGULLORJA E RESTORANTEVE SHKOLLORE

VITI SHKOLLOR 2022-2023

Ville de Lancy

République et canton de Genève



Ville de Lancy
Service des affaires
sociales et du logement
Avenue Eugène-Lance 3
1212 Grand-Lancy
Tel. 022 706 16 66

PREAMBULA

Në plotësim të ofertës së GIAP (Grupimi ndër-komunal për animacion parashkollor) në nivel të shoqërimit parashkollor, qyteti i Lancy ofron një shërbim të restoranteve shkollore, të ndarë në tetë lokale të rregulluara brenda shkollave të Lancy.

Restorantet shkollore të Lancy janë vlerësuar me etiketën “Fourchette verte junior” (Piruni i gjelbër junior). Ky etiketim konfirmon që fëmijëve u servohet një shujtë ditore e shëndetshme dhe e balancuar, në një ambient të përshtatshëm, i cili iu përgjigjet normave të etiketës.

SHËRBIMI PËRGJEGJËS

Shërbimi përgjegjës për menaxhimin e restoranteve shkollore është Shërbimi i punëve sociale dhe i strehimit të Qytetit të Lancy, avenue Eugène-Lance 3, 1212 Grand-Lancy, tel. 022 706 16 66.

MARRËDHËNIET ME GIAP

Për të frekuentuar restorantet shkollore, fëmijët duhet paraprakisht të jenë të regjistruar pranë GIAP. Çmimi i shujtave i cekur brenda kësaj rregulloreje nuk përfshin kostot e përkujdesjes së fëmijës. Këto kosto faturohen drejtpërdrejt nga GIAP.

Prezencat janë të regjistruara në baza ditore nga animatorët e GIAP, të cilët informojnë shërbimin kompetent.

FUNKSIONIMI I RESTORANTEVE SHKOLLORE

Restorantet shkollore janë të hapur të hënën, të martën, të enjten dhe të premten për fëmijët të cilët i frekuentojnë shkollat e Lancy nga klasa1 deri në klasën e 8 filllore. Animatorët e GIAP kujdesen për fëmijët e regjistruar në fund të orarit të secilës shkollë, pra në orën 11:30. Fëmijët shoqërohen deri në restorantit ku do të hanë. Aktivitete të ndryshme u propozohen fëmijëve para dhe/ose pas ngrënies.

Fëmijët vendosen nën përgjegjësinë e animatorëve të GIAP; nuk largohen nga aty pa lejen e tyre dhe nuk largohen nga vendi i grumbullimit.

MENYTË DHE DIETAT

Parimisht, restorantet shkollore ofrojnë shujtën e njëjtë për të gjithë fëmijët. Menytë publikohen zakonisht një javë më herët në panelet e parashikuara për këtë qëllim si dhe në webfaqen e komunës.

Aty ku është e mundur dhe duke respektuar kushtet e përgjithshme të GIAP, zgjidhje të përshtatshme do të kërkohen në rastet ku fëmija duhet të përfitojë nga një dietë ushqimore specifike. Sipas direktivës së Shërbimit të shëndetit të rinisë të Departamentit të Udhëzimit publik, infermieri/ja i/e shkollës harton një Projekt individual të mikpritjes (PAI).

Praktika ushqimore vegjetariane që ndërlihet me vlerat familjare si dhe ajo që ndërlihet me bindjet fetare të shënuara në formularin e regjistrimit respektohen, pa krijuar një meny të veçantë dhe pa u dhënë mundësi prindërve që të sjellin ushqime shtesë në shujtën e ofruar nga restoranti i shkollës. Në të gjitha rastet e tjera, një kufizim në ushqim duhet të arsyetohet me një certifikatë mjekësore. Një ushqim nuk do të largohet nga shujta e një fëmije pa këtë dëshmi zyrtare. Në raste të alergjive ndaj disa substancave ushqimore, përfaqësuesit ligjorë duhet të sigurojnë shujtat për fëmijën. Ky i fundit do ta konsumojë atë në sallë me shokët/shoqet e tij/saj. Janë të zbatueshme direktivat në lidhje me Shërbimin e shëndetit të rinisë të Departamentit të edukimit publik.

REGJISTRIMET

Në përputhje me kushtet e përgjithshme të GIAP, regjistrimet kryhen vetëm online përmes portalit my.giap.ch. Për prindërit të cilët nuk kanë mundësi të hapin një llogari e-démarche, ju lutemi të kontaktoni qendrën e regjistrimeve përmes telefonit 022 304 57 70.

Gjatë regjistrimit, përfaqësuesi ligjor përcakton, për të gjithë vitin shkollor, ditën apo ditët e javës gjatë të cilës/cilave fëmija do të frekuentojë restorantin e shkollës.

Përmes nënshkrimit të formularit të regjistrimit ose përmes vërtetimit të tij online, përfaqësuesi ligjor vërteton pranimin e të gjitha kushteve të përgjithshme të vendosura nga GIAP dhe Restoscolaire si dhe rregulloren e restoranteve të shkollave të Qytetit të Lancy.

ÇMIMI I SHUJTAVE

Shujtat faturohen me çmimin prej CHF 8.- në ditë dhe për fëmijë.

MUNGESA NË SHUJTA

Mungesat e mundshme në vakte duhet të njoftohen detyrimisht para orës 8 në platformën "Rest-toscolaire" duke u kyçur në portalin parashkollor my.giap.ch ose në sekretarinë telefonike të GIAP të shkollës përkatëse, numri i telefonit i së cilës ju jepet gjatë regjistrimit. Duke treguar në mënyrë të qartë mbiemrin dhe emrin e fëmijës, si dhe ditën ose ditët e mungesës së paraparë.

Të gjitha ndryshimet lidhur me programin e planifikuar gjatë regjistrimeve (mungesa ose prezenca shtesë) mund të modifikohen në portalin parashkollor my.giap.ch. Ky hap i obligueshëm do të kursejë animatorët nga kërkimi i fëmijës dhe kontaktimi i panevojshëm i përfaqësuesve ligjorë.

Shujtat e fëmijëve të cilët kanë njoftuar për mungesën e tyre brenda afatit të lartcekur nuk do të faturohen. Shujtat e fëmijëve të cilët nuk kanë njoftuar për mungesën e tyre ose kanë njoftuar pas orës 8 do të faturohen me çmimin e zakonshëm, pra CHF 8.- për shujtë.

FATURIMI

Qyteti i Lancy është bërë pjesë e platformës "Restoscolaire" të Shoqatës së komunave të Gjenevës, që mundëson menaxhimin e prezencës së fëmijëve dhe parapagimin e shujtave.

Prindërit kryejnë, në fillim të vitit shkollor, një parapagim. Shuma fillestare duhet të mbulojë çmimin e shujtave për një muaj për secilin nga fëmijët e regjistruar. Pagesat e radhës duhet të jenë të mjaftueshme në mënyrë që saldoja në dispozicion të jetë në minimum prej 5 shujtave për fëmijë.

Referencat e pagesave për e-banking janë të qasshme në portalin parashkollor my.giap.ch në pjesën e rezervuar për Retroscolaire.

Prindërit të cilët nuk kanë internet ose nuk dëshirojnë të paguajnë përmes e-banking kanë mundësinë që të kërkojnë BVR, kjo procedurë përmban kosto administrative. Ju lutem të kontaktoni qendrën e thirrjeve përmes telefonit në 058 307 84 64.

Në rast të saldos (shumës) së pamjaftueshme, një pasqyrë e llogarisë me koston përkatëse të rikujtimit do t'u dërgohet prindërve përmes postës.

Në rast të mos pagesës pas rikujtimeve, do të zbatohet procedura e rikuperimit nga Zyra e Hetimeve, Qyteti i Lancy e merr të drejtën që të pezullojë shërbimet, që do të thotë të përjashtojë fëmijën nga restorantet e shkollës.

Në rast të vështirësive financiare, përfaqësuesit ligjor janë të ftuar të ndërliken sa më shpejtë me Shërbimin e restoranteve të shkollave të Qytetit të Lancy përmes telefonit 022 706 16 78.

Për më tepër, shërbimi i punëve sociale i qytetit të Lancy është në dispozicion për të vlerësuar situatën dhe kërkesat e përfaqësuesve ligjorë. Asistentët socialë janë në dispozicion për takim në bazë të terminit, përmes telefonit në numrin 022 706 16 66.

NDËRPRERJA OSE MODIFIKIMI I REGJISTRIMIT

Çdo ndryshim i kontratës së përkujdesjes mund të bëhet online në portalin my.giap.ch ose duke njoftuar me shkrim Përgjegjësin e sektorit të GIAP para datës 25 të muajit vijues ashtu që ky ndryshim të merret parasysh nga fillimi i muajit pasues.

Ndërprerja e kontratës së përkujdesjes duhet të njoftohet me shkrim te Përgjegjësi i sektorit të GIAP para datës 25 të muajit vijues ashtu që kjo ndërprerje të merret parasysh nga fillimi i muajit pasues. Kjo nuk mund të bëhet përmes portalit my.giap.ch.